

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për miratimin e planit të menaxhimit për Butrintin”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë nga data 3 tetor 2018 deri më 18 mars 2020. Këtu përfshihen: prezantimi i Planit të Menaxhimit të Integruar (PMI), takimet publike, konsultimi përmes shkresave zyrtare dhe konsultimi përmes regjistrit elektronik. Aktiviteti i parë mbi konsultimin u përqendrua në prezantimin e qasjes së propozuar nga konsulenti për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Integruar, gjatë paraqitjes publike të projektit në Tiranë, më 3 tetor 2018. Më 6 tetor 2018, në Sarandë, u organizua një seminar me palët e interesit.

Takimet publike u realizuan:

- Në datë 4 tetor 2019, ora 10:00, në Bashkinë e Sarandës, ku ishin të pranishëm Ministri i Kulturës, kryetari i bashkisë së Sarandës, specialistë të fushës, përfaqësues të operatorëve turistikë, etj.;
- Në datë 4 tetor 2019, ora 13:00, në Parkun Kombëtar të Butrintit, ku morën pjesë Ministri dhe përfaqësues të lartë të Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Konispol, specialistë të fushës së trashëgimisë kulturore, arkeologë të Institutit Arkeologjik, Akademia e Studimeve Albanologjike, përfaqësues të komunitetit vendas nga njësitë administrative Konispol, Xarrë, Markat, artizanë vendas që ushtrojnë aktivitetet sezonal në Parkun Kombëtar Butrint, drejtori dhe specialistët e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint, etj.;
- Në datë 15 nëntor 2019, në “The Plaza Tirana”, ku morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Kulturës, përfaqësues të institucioneve qendrore përgjegjëse për kulturën, natyrën, planifikimin urban, përfaqësues të institucioneve të specializuara pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike, personalitete akademike dhe studiues të fushës së trashëgimisë, mjedisit, planifikimit urban, turizmit, grupe interesi dhe përfaqësues të komunitetit lokal;
- Më datë 24 janar 2020, në selinë e Qendrës së Trashëgimisë Botërore (QTB) në Paris u zhvilluan dy takime pune me përfaqësues të QTB-së, ICOMOS-it dhe ICCROM-it, MK-së, IKTK-së, ekipit konsulent, në prani të ambasadorit të Misionit të Përhershëm të Shqipërisë në UNESCO.

Procesi i konsultimit përmes regjistrit elektronik në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP) u hap më 26 dhjetor 2019.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për miratimin e planit të menaxhimit për Butrintin”, ishin si më poshtë:

1. Konsultimet elektronike, njoftuar përmes RENJKP-së.
2. Takimet publike në ambientet e MK-së, Bashkisë Sarandë, Parkut Kombëtar Butrint, njoftuar përmes postës elektronike, në datat: 4 tetor 2019 ora 10:00; 15 nëntor 2019; 24 janar 2020.
3. Lajmërim në mediat online, e shkruar dhe televizive:
 - <https://shqiptarja.com/video/plani-i-menaxhimit-te-butrintit-specialistet-eshte-risi-por-drejtori-duhet-shqiptar>;
 - <https://24-ore.info/butrinti-me-fondacion-ceka-intelektualet-nuk-jane-kepuce-margariti-jo-me-metafora/> / <https://balkanëeb.com/blog/?cat=306>.
4. Posta elektronike.
5. Faqja zyrtare e Ministrisë së Kulturës, datat: 03/10/2018; 21/11/2019.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

1. Qytetarët: Kanë patur mundësinë e dhënies së kontributit përmes linkut: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/245>, por nuk ka pasur komente.
2. UNESCO - përfaqësues të QTB-së, ICOMOS-it dhe ICCROM-it;
3. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë;
4. Zyra për Administrim dhe Koordimin të Parkut Kombëtar të Butrintit;
5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
7. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Instituti i Monumenteve Kulturore (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore);
9. Instituti i Arkeologjisë;
10. Universiteti i Tiranës;
11. AKZM – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
12. AdZM Vlorë– Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Vlorë;
13. Akademia e Studimeve Albanologjike;
14. Përfaqësues të komunitetit vendas nga njësitë administrative Konispol, Xarrë, Markat, artizanë vendas që ushtrojnë aktivitetet sezonal në Parkun Kombëtar Butrint;
15. Akademikë dhe studiues të fushës së trashëgimisë, mjedisit, planifikimit urbanizimit, turizmit;

❖ Numri i palëve të përfshira: 15.

❖ Numri i komenteve të pranuar: 15.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<p>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
<p>Dëgjesë publike në Bashkinë Sarandë, specialistë të mjedisit, trashëgimisë kulturore, përfaqësues të operatorëve turistikë, etj. 4 tetor 2019</p>	<p>U vlerësuan risitë e draft-planit dhe u dhanë sugjerime në funksion të pasurimit të PMI me elementë që qasin Butrint si lider në menaxhimin e siteve mikse me elemente kulturore dhe natyrore</p>	<p>Operatorët turistikë Bashkia Sarandë Specialistë të fushave të mjedisit dhe trashëgimisë kulturore Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Studiues të fushës së trashëgimisë, mjedisit AdZM Vlorë– Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura</p>	<p>Janë marrë në konsideratë sugjerimet e Bashkisë Sarandë dhe operatorëve turistikë për ta pasuruar PMI me elementë që burojnë nga synimi dhe vizioni që Butrinti dhe Parku Kombëtar të jetë një lider botëror në menaxhimin e qëndrueshëm të siteve mikse me elemente kulturore dhe natyrore, të ngritur në statusin e një qendre të ofertës turistike rajonale dhe model për parqe të tjera në Shqipëri. Në PMI janë parashikuar ndër të tjera aktivitete të lidhura me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Akses i kontrolluar në sit. <p>Planifikimi për vënien në përdorim të automjete</p>	

		Vlorë;	<p>ekologjike për lëvizjen e turistëve nga qendra e re e vizitorëve drejt hyrjes në Qytetin Antik;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shtigjeve për ecje dhe pedalim me biçikletë rreth Parkut dhe inkurajimi i vizitorëve për përdorimin e tyre. - Planifikimi dhe zbatimi i projekt-propozimit të një qendre vizitorësh për Parkun ku janë të integruara të gjitha shërbimet e nevojshme për aksesin e vizitorëve; Krijimi i markës “Butrint” për të promovuar vlerat e jashtëzakonshme universale të Parkut Kombëtar përmes reklamimit dhe tregtimit. - Implementimi i një sistemi të integruar bashkëkohor sigurie; - Implementimi i programeve afatgjata për trajnimin e vazhduar të stafit teknik dhe mirëmbajtjes; - Hartimi i një programi të kërkimit shkencor që ndërthur të gjitha aspektet e trashëgimisë 	
--	--	--------	--	--

			kulturore dhe natyrore të Parkut Kombëtar;	
Dëgjuesë publike me Bashkinë Konispol, specialistë të mjedisit, trashëgimisë kulturore, përfaqësues të komunitetit vendas, artizanë 4 tetor 2019	U vlerësuan risitë e draftit të planit dhe dhanë sugjerime me synim mirëqenien dhe e rritjen e nivelit ekonomik të komunitetit vendas	Bashkia Konispol, Përfaqësues të komunitetit vendas nga njësitë administrative Konispol, Xarrë, Markat artizanë vendas që ushtrojnë aktivitet sezonal në Parkun Kombëtar Butrint Zyra Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint, etj. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Akademia e Studimeve Albanologjike/Instituti Arkeologjik	Janë marrë në konsideratë sugjerime të përfaqësuesve të komunitetit vendas për ta pasuruar PMI veçanërisht me elementë që ndikojnë në rritjen e nivelit ekonomik të familjeve të komunitetit vendas. Në PMI janë parashikuar ndër të tjera aktivitete të lidhura me: <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e ndërgjegjësimit publik, përfshirja e komunitetit dhe përfaqësuesve të autoriteteve lokale në ruajtjen e vlerave kulturore dhe mjedisore në funksion të për një zhvillim të qëndrueshëm; - Krijimi i një programi bashkëpunimi të ekspertëve dhe fermerëve lokal për të zhvilluar praktika të qëndrueshme mjedisore; - Sigurimi i lehtësirave dhe trajnimeve për zhvillimin e industrisë lokale artizanale dhe përfshirjen e produkteve të mirëfillta nën markën “Butrint”; - Zhvillimi dhe shtrirja e programeve edukative për te 	

			gjitha ciklet shkollore ne zonën lokale dhe rajonin e gjerë.	
Dëgjesa publike në lidhje me Drafti Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar Butrint 2020-2030”, Tiranë, date 15 nëntor 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i PMI-së si një risi. - Mungesa e pasqyrimin në PMI të pasurisë nënujore. - Menaxhimi të bëhet nga një fondacion i pavarur nga shteti, por me rezerva për sa i përket menaxhimit nga të huajt. 	<p>Universiteti i Tiranës;</p> <p>Akademia e Studimeve Albanologjike_ Instituti i Arkeologjisë</p> <p>Akademikë dhe studiues të fushës së trashëgimisë, mjedisit, planifikimit urbanizimit, turizmit, ekonomisë</p>	<p>Marrë në konsideratë dhe reflektuar në PMI dhe Plan Veprimi</p> <p>Dhënë sqarimet e nevojshme: Fondacioni i posaçëm do të krijohet me një ligji të ri në marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Partnerit Strategjik. Krijimi i Fondacionit bazohet në nenin 172 të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM-së nr.625, datë 4.9.2019 “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit” dhe udhëzimit nr. 583, datë 14.10.2019 të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”.</p> <p>Miratimi me VKM së Planit të Integruar të Menaxhimit të PK Butrint do të pasohet nga marrëveshja e menaxhimit që do të nënshkruhet midis</p>	

	<p>- Grupi kërkimor i Butrintit do të jetë një entitet i përhershëm brenda strukturës menaxhuese, apo do të ekzistojë në mënyrë të pavarur?</p>		<p>Ministria e Kulturës dhe fondacionit të ri, e cila do të vendosë detyrimet dhe detyrat specifike të palëve.</p> <p>Ministria e Kulturës në çdo rast do të garantojë mbrojtjen e nevojave të menaxhimit të pasurisë në dy nivele: si bashkëthemelues, përmes pjesëmarrjes në Bordin e Drejtorëve, organi më i lartë vendimmarrës i fondacionit të ri, dhe si palë mbikëqyrëse e shtetit që do të sigurojë përmbushjen e çdo detyrimi nga marrëveshja e menaxhimit.</p> <p>Dhënë sqarime të mëtejshme si dhe reflektuar në draftin e rishikuar të PMI dhe Plan Veprimit</p> <p>Ne mënyrë të përmbledhur, synimi i grupit kërkimor është të ofrojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbështetje teknike dhe akademike. <p>Në bashkëpunim me institucionet e specializuara do të përcaktojë kushtet për kërkimin shkencor, inventarin dhe monitorimin mjedisor,</p> <ul style="list-style-type: none"> - platformën Arkeologjike të Kërkimit për të ofruar kuadër dhe udhëzime të qarta për gërmimet në të ardhmen - hartimi i një programi gërmimesh që 	
--	---	--	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim për burimet njerëzore - Raporti që ka menaxhimi i zonës A3 me zonën tjetër të parkut. - Roli i kërkimit shkencor në planin e ri të menaxhimit të Butrintit. 		<p>të jetë i përshtatshëm për arkeologët vizitues</p> <p>-hartimi i një programi mbarëkombëtar për të ofruar mundësi trajnimi praktik në terren për studentët shqiptarë të arkeologjisë</p> <p>- përfshirja e studentëve shqiptarë në misionet ndërkombëtare të gërmimit, Etj.</p> <p>Grupi kërkimor do të financohet nga fondacioni i ri, për të kryer punë kërkimore, në funksion të së ardhmes së sitit.</p> <p>Dhënë sqarime dhe reflektuar në draftin e rishikuar të PMI analiza e kapaciteteve njerëzore</p> <p>Dhënë sqarime dhe reflektuar në PMI e rishikuar</p> <p>Dhënë sqarime dhe reflektuar në PMI e rishikuar:</p> <p>Butrinti është ndër sitet më të rëndësishme në Shqipëri për kërkimin</p>	
--	--	--	--	--

			shkencor në një sërë disiplinash, si historia, arkeologjia, shkencat e natyrës, PMI propozon ngritjen e një organi të posaçëm kërkimor-shkencor, Grupi Kërkimor Butrinti, të përkushtuar në avancimin e njohurive kërkimore.	
Konsultim dhe takim me organet këshillimore të QTB/UNESCO ICOMOS dhe ICCROM	Sugjerime dhe kërkesat për informacion të mëtejshëm:	<p>UNESCO/QTB (Qendra e Trashëgimisë Botërore)</p> <p>ICOMOS International Council of Monuments and Sites (Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Siteve)</p> <p>ICCROM-International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property</p>	<p>Me shkresë nr.1829/1 – 03.09.2019 IMK ka përcjellë në QTB/UNESCO draftin e PMI</p> <p>Me shkresë (e-mail) të datës 18 Nëntor 2019 QTB përcjell në MK Rekomandimet e ICOMOS-ICCROM</p> <p>Me shkresë nr.20/19, datë 20 Janar 2020 Delegacioni i Përhershëm i Shqipërisë pranë UNESCO përcjell në QTB draftin e rishikuar të PMI ku janë reflektuar komentet e ICOMOS dhe ICCROM</p> <p>Referuar komenteve të ICOMOS dhe ICCROM, u bë rishikimi i draftit të</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> - Qëllimet e PMI në lidhje me vlerën e jashtëzakonshme universale të pasurisë mund të paraqiten më herët në plan. - Para se plani të finalizohet dhe të miratohet zyrtarisht, duhet të rishikohet nga organizata vendore shqiptare, përfshirë ato akademike. - Shteti Palë duhet të konfirmojë që modele të tjera organizative përveç fondacionit të propozuar janë studiuar dhe krahasuar 	<p>(Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore)</p>	<p>planit duke shtjelluar, sqaruar, plotësuar dhe dhënë detaje të mëtejshme në linjë me kërkesat dhe rekomandimet e të dy trupave këshillimore përmbledhur si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Është marrë në konsideratë rekomandimi dhe reflektuar në seksionet e para të PMI. - Është marrë në konsideratë rekomandimi, përmbajtja e PMI është konsultuar me institucione vendore si dhe akademike (Instituti Arkeologjik) dhe ministritë e linjës - Është marrë në konsideratë: janë shqyrtuar dhe reflektuar ne draft Plan disa modele alternative të aplikuara ne vende të ndryshme: ShBA, Georgji, Itali, Francë, Turqi, 	
--	--	---	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> - Detaje të tjera duhet të jepen për natyrën e saktë të marrëdhënieve midis fondacionit të ri të Butrintit dhe Autoritetit të ri të Parkut Kombëtar. - Shteti Palë duhet të marrë menjëherë në konsideratë krijimin e një autoriteti / fondacioni të vetëm për të menaxhuar pronën e Trashëgimisë Botërore dhe zonën de-fakto mbrojtëse / Parkun Kombëtar në një administrim të integruar dhe një plan menaxhimi të vërtetë të integruar. - Grupi i Kërkimeve Butrint duhet të hartojë një plan të Hulumtimit Arkeologjik dhe udhëzime të qarta për gërmimet në të ardhmen. 		<p>Bosnje- Hercegovinë, Kroaci, Greqi, Itali, Mali i Zi, Serbi dhe Slloveni.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Është marrë në konsideratë. Janë dhënë sqarime të mëtejshme. - Është marrë në konsideratë dhe reflektuar në draftin e rishikuar të PMI. - Është marrë në konsideratë: PMI është rishikuar duke përfshirë rekomandimin për Grupin Kërkimor Butrint për përgatitjen e 	
--	---	--	--	--

	<p>- Ndryshimet e sugjeruara të kufirit duhet të propozohen si një modifikim i vogël i kufijve për t'iu paraqitur Komitetit të Trashëgimisë Botërore në përputhje me Paragrafin 164 të Udhëzimeve Operacionale.</p>		<p>një Plan të hulumtimit arkeologjik me udhëzime edhe për gërmimet në periudhën objekt i planit</p> <p>- Është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në draft e rishikuar të PMI</p> <p>Në takimin e datës 24 janar 2020, të zhvilluar me përfaqësues të QTB-së, ICOMOS-it dhe ICCROM-it, përfaqësues të Ministrisë së Kulturës dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhanë sqarime në lidhje me reflektimin e rekomandimeve të ICOMOS-it dhe ICCROM-it në draftin e PMI-së të dërguar me shkresën nr.20/19 prot., datë 20 janar 2020.</p>	
<p>Konsultimi i dytë me ICOMOS-in</p>	<p>Në vijim të përcjelljes së draftit të rishikuar të PMI dhe takimit në QTB të datës 24 janar 2020, QTB përcjell kërkesat e dyta të ICOMOS në lidhje me:</p>	<p>QTB Qendra e Trashëgimisë Botërore</p>	<p>Me shkresën e datës 17 mars 2020 është përcjellë pranë Delegacionit të Shqipërinë në UNESCO përgjigjet për kërkesat e ICOMOS, si vijon:</p>	

	<p>-Organin (strukturën) qeveritare që do të jetë përgjegjës për administrimin e pasurisë së Trashëgimisë Botërore “Butrint”</p> <p>-shqyrtimin e modeleve organizative të tjera alternative përveç fondacionit të propozuar për të cilat të jepen detaje,</p> <p>-natyrën e saktë të marrëdhënieve midis fondacionit të ri të Butrintit dhe Autoritetit të ri të Parkut Kombëtar që propozohet të krijohet,</p> <p>- rekomandim që zbatimi i PMI do të monitorohet nga</p>		<p>Është dhënë sqarim në lidhje me organin që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e pasurisë trashëgimisë botërore shoqëruar me skemës shpjeguese</p> <p>Është marrë në konsideratë: janë shqyrtuar dhe reflektuar në draft-Plan disa modele alternative të aplikuara nga vende si: SHBA, Gjeorgji, Itali, Francë, Turqi, Bosnjë- Hercegovinë, Kroaci, Greqi, Itali, Mali i Zi, Serbi dhe Slloveni</p> <p>Janë dhënë sqarime në lidhje me Autoritetin e Parkut dhe Fondacionin e Ri</p> <p>-Është marrë në konsideratë rekomandimi që zbatimi i PMI të</p>	
--	---	--	---	--

	<p>një autoritet i vetëm</p> <p>-angazhimin financiar të AADF-së për të financuar planin e veprimit të propozuar në draft PMI</p> <p>-kontributin financiar të autoriteteve shqiptare,</p> <p>-s qarime në lidhje me statusin juridik të qendrës së vizitorëve të propozuar</p>		<p>monitorohet nga një autoritet i vetëm për sitin pasuri botërore dhe zonën mbrojtëse, <i>de facto</i> Parkun Kombëtar</p> <p>Është dhënë sqarim që angazhimi i AADF-së do t'i nënshtrohet dokumenteve ligjore që do të hartohen në rast se kërkesa për krijimin e një fondacioni të veçantë do të pranohet zyrtarisht (miratohet).</p> <p>Është dhënë sqarim që fondacioni i ri, do të bashkë-themelohej me fonde nga Partneri Strategjik dhe Ministria e Kulturës që vepron në emër të qeverisë së Shqipërisë. Angazhimi i institucioneve të Shtetit Palë do t'i nënshtrohet dokumenteve ligjore që do të hartohen në rast se kërkesa për krijimin e një fondacioni të veçantë do të miratohet zyrtarisht.</p> <p>Është dhënë sqarim që, vetëm pas përfundimit të procedurës ligjore të nevojshme dhe miratimit të shprehjes</p>	
--	---	--	---	--

	<p>- Vlerësimi i mundësisë për zgjerim të mundshëm të kufijve të pasurisë botërore për përfshirjen e një pjese të nënzonës A3 në perëndim të pronës pasuri botërore</p>		<p>së interesit të AADF-së, hartimi i projekt-idesë dhe projektit të zbatimit për Qendrën e Vizitorëve do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga organet vendimmarrëse të ngarkuara me ligj. Këto do të përfshijnë gjithashtu VNM dhe VNTK. Në përputhje me paragrafin 172 të Udhëzimeve Operative për zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore, Shteti Palë do të njoftojë paraprakisht Qendrën e Trashëgimisë Botërore</p> <p>Nuk është marrë parasysh</p>	<p>Zgjerimi i kufirit të pronës do të ketë efektin e padëshiruar të përfshirjes së një pjese të qytetit të Ksamilit brenda pronës pasuri botërore. Prandaj, këta ishuj duhet të qëndrojnë si një pjesë e ndarë nga prona pasuri botërore.</p>
--	---	--	---	---